



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, Datë 12.07.2019

PËR

**MIRATIMIN E PLANIT TË DETAJUAR TË ZONAVE ME RËNDËSI KOMBËTARE
GROPA E PORTËS, FUSHË OKOL DHE QAFË THORE NË AFËRSI TË FSHATIT
BOGË, MALËSI E MADHE**

Në mbështetje të neneve 7, 9, 18 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Detajuar të Zonave me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) Gropa e Portës, Fushë Okol dhe Qafë Thore në afërsi të fshatit Bogë, Malësi e Madhe.
2. Dokumenti i plotë i Planit të Detajuar të Zonave me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) Gropa e Portës, Fushë Okol dhe Qafë Thore në afërsi të fshatit Bogë, Malësi e Madhe përmban:
 - a) *Planin e Detajuar të Zhvillimit;*
 - b) *Rregulloren e Detajuar të Planit;*
 - c) *Hartat shoqëruese.*
3. Gjatë hartimit të planeve të tjera sektoriale, planeve të detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe gjatë shqyrtimit dhe miratimit të

lejeve të zhvillimit/ ndërtimit, autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit në nivel qendror, qarku dhe atë vendor, duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Detajuar i Zonave me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) Gropa e Portës, Fushë Okol dhe Qafë Thore në afërsi të fshatit Bogë, Malësi e Madhe.

4. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit, që hartohen nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit të territorit, me përcaktimet e Planit të Detajuar të Zonave me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) Gropa e Portës, Fushë Okol dhe Qafë Thore në afërsi të fshatit Bogë, Malësi e Madhe.
5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për shqyrtimin e dokumentacionit të aplikimeve për leje zhvillimi/ ndërtimi në përputhje me përcaktimet e Planit të Detajuar të Zonave me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) Gropa e Portës, Fushë Okol dhe Qafë Thore në afërsi të fshatit Bogë, Malësi e Madhe.
6. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Bashkia Malësi e Madhe për zbatimin e këtij Vendimi.
7. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

BLENDI KLOSI



MINISTËR I TURIZMIT DHE MËDISIT



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

